




Pranuar / Dorezuar Primiencë/Prisada Received/Delivery	08.04.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SANKUK/1698/2021			1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.103/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional-procesmbajtëse, kanë shqyrtuar ankesën me numër protokollit 829/2021 të datës 25.02.2021 të parashtruar nga ankuesi Prishtinë , kundër organit të punësimit- Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës/Gjykata Supreme e Kosovës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 08.04.2021, mori këtë .

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.103/2021 e datës 25.02.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i caktuar në pozitën e Zyrtar për Teknologji Informative në dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës sipas akt emërimit të datës 18.01.2019 me numër protokollit 20/2019, me datë 07.02.2019 Sekretariati i Këshillit Gjyqësor i Kosovës ka parashtruar kërkesë për aprovimin e shtesës në pagë në Komisionin për shqyrtimin e shtesave të fushës së Teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut në Ministrinë e Administratës Publike, i cili komision ka kërkuar nga organi i punësimit dokumente përcjellëse për shqyrtimin e kërkesës. Zyra e personelit me datën 28.02.2019 i ka përcjell dokumentet e kërkuara nga Komisionin për shqyrtimin e shtesave të fushës së Teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut në Ministrinë e Administratës Publike akt emërimin , diplomën dhe certifikatat e kërkuara.

Edhe pse organi i punësimit vazhdimisht ka kërkuar nga Komisionin për shqyrtimin e shtesave të fushës së Teknologjisë Informative dhe Inxhinieringut në Ministrinë e Administratës Publike realizimin e shtesës në pagë jo vetëm për ankuesin z por edhe për zyrtarë tjerë të IT-së nuk ka marrë përgjigje nga ky komision.

Ankuesi me datën 26.01.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për realizimin e shtesës në pagë bazuar në vendimin nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me vendimin K.A.nr.08/2021 i datës 27.01.2021 me numër protokollit 133 ka shpallur veten **jo kompetent** për vendosjen e ankesës së ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin K.A.nr.08/2021 i datës 27.01.2021 me numër protokollit 133 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me datë 25.02.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 829/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.03.2021 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës më datë 15.03.2021 ka dërguar në Këshill përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/12.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 829/2020 të datës 25.02.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 08.10.2008 me Nr.01/39 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimi i datës 08.10.2008 me Nr.02/39 i Qeverisë së Republikës së Kosovës; Lista dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Ankesa e datës 26.01.2021 e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; Vendimi i datës 27.01.2021 me numër protokollit 133 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës; e-mail zyrtar i datës 29.01.2020; E-mail zyrtar i datës 22.02.2019; E-mail zyrtar i datës 07.02.2019; E-mail zyrtar i datës 28.02.2019; Akt emërimi i datës 21.01.2019; E-mail i datës 18.11.2020; E-mail 17.11.2020 dhe përgjigje në ankesë nga organi i punësimit e datës 15.03.2021 bashkë me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit, **është e pa bazuar sepse:**

Bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht akt emërimit të datës 18.01.2019 me numër protokollit 20/2019, Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në pozitën e punës Zyrtar për Teknologji Informativë në dhomën e posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ankuesi me datën 26.01.2021 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për realizimin e shtesës në pagë bazuar në vendimin nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, lidhur me njohjen e të drejtës për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës me vendimin K.A.nr.08/2021 i datës 27.01.2021 me numër protokollit 133 ka shpallur veten jokompetent për vendosjen e ankesës së ankuesit.

Kundër Vendimit K.A.nr.08/2021 të datës 27.01.2021 me numër protokollit 133, ankuesi brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qellim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të



konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, se paku një herë në gjashtë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: *1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut.* Përkritazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të këtij akti nënligjor janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhëne edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që duke u bazuar në këtë konstatim, Kolegji vlerëson se Komisioni i Ankesave në Komunën e Skenderajt, me rastin e aprovimit të shtesës së TI-së për ankuesin nuk ka zbatuar drejtë dispozitat materiale, dhe se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe vendosjen e Ankesave, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka arritur të konstatojë se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet ti ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërin e realizimit të shtesës dhe një analize që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar. Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2 dhe 1.5 si dhe nenin 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.103/2021; Datë 08/04/2021

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet;

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

